



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
30.09.2024

Me datë 30.09.2024, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Suada Kopshti, Marina Duhani, Erkan Hoxha, Vjoleta Përndrecaj, Ardita Spahija, Gloria Shllaku, Gjovalin Ndoj, Samed Bushati, Fatmir Vojvoda, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Amina Lici, Muharrem Shkjau, Plarent Anamali.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2024".*
2. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Gusht 2024".*
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024" (P.Bashkiake)*
4. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e nivelit të pagava të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civil, të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë".*
5. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. (Ndryshim Nr.i punonjësve)*
6. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar*

2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. (Menaxhimi infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes).

7. Pr/ Vendim: "Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. (Rikonstruksioni i banesave sociale/ndërtim strehëza e qenëve).
8. Pr/ Vendim: "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit brenda të njëjtit program për vitin 2024"(Blerje pushke CO2 për klinikën në strehëz).
9. Pr/ Vendim: "Për miratimin e udhëzuesit të aplikimit për zbatimin e skemës së granteve".
10. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër,së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Znj.Merita Sheqeri, Z.Fatbardh Beqiri, Znj.Semiha Çelepija, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri".
11. Pr/ Vendim: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025".
12. Pr/ Vendim: "Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024"
13. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Gjithashtu **Z.Luli** shton se rendit të ditës i shtohet edhe një tjetër Pr/vendim "Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr.6 (ish-Konvikti i Shkollës Pyjore).

Para se të hidhet në votim rendi i ditës fjalën e merr **Znj.Shkrela** e cila për procedurë shprehet se grupi i koalicionit "Bashkë Fitojmë" kanë kërkuar që në mbledhjet e Këshillit të jetë i pranishëm Kryetari i bashkisë, pasi mosprezenca e tij nuk është aspak serioze.

Z.Bjanku përgëzon administratën e Bashkisë për sjelljen e materialeve në kohë por kërkon gjithashtu që materialet të vijnë të sakta në përmbajtje që të kemi mundësi diskutimi në mbledhjet e komisioneve. Ai kërkon heqjen nga rendi i ditës pr/vendimin nr.7 pasibëhet fjalë për një fond të konsiderueshëm parash që i shtohen një fondi tashmë të miratuar në Këshill. **Z.Luli** sqaron se rendi i ditës do hidhet në votim ashtu siç është miratuar në kryesisë së Këshillit.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **11** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2024".

Siç është rënë dakort, kryetarët e grupeve, mendojnë se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativim pasi është i përnuajshëm. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **43** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Po ashtu hidhet në votim edhe Pr/vendimi nr.2: "*Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Gusht 2024, ku rezultojnë **43** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.*

Miratohet

Kalohet në pikën e 3-të të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "*Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024*"

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Myrtaj**, drejtor i Policisë bashkiake, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Bjanku** dhe thotë se në dijeninë e tij Bashkia Shkodër po përgatit një projekt për parkingjet, ku për këtë do jetë përgjegjëse një kompani private, e cila do ketë mjetin e saj (karroatrec) dhe po shpenzojmë kot.

Përgjigjet **Z.Myrtaj** duke thënë se nëse e marrim të mirëqënë këtë çka thatë, kompania do jetë përgjegjëse vetëm për parkingjet me pagesë. Blerja e karroatrecit shërben për të liruar hapësirat nga makina të parkuara gabim.

Z.Haxhi merr fjalën dhe kërkon të dijë nëse fondi në fjalë është tepriçë nga blerja e uniformave apo apo nuk është realizuar ndonjë nga zërat e programit dhe mendohet të mbulohet me këtë kjo blerje?

Përgjigjet **Z.Myrtaj** duke thënë se është tepriçë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Z.Ndou** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort, kurse **Z.Osmanagaj** nga kualicioni BF dhe **Z.Sokoli** nga PD janë kundër Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **30** vota Pro, **11** Kundër, **1** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e radhës: Pr/ Vendim: "*Për miratimin e nivelit të pagava të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civil, të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë*".

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Lesha**, drejtor i Përgjithshëm Juridik, në bashkië Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.I.Sokoli** dhe shprehet se sipas VKM-së për pagat , thuhet se rritja e pagave do bëhet nga të ardhurat e vetë Bashkisë. Duke patur parasysh këtu shpenzimet operative bashkë me shpenzimet për pagat shkon rreth 87% e buxhetit. Lind pyetja sa do rriten kundrejt buxhetit total shpenzimet operative sepse me 13% shpenzime kapitale, Bashkia Shkodër kthehet vetëm në një agjensi punësimi duke i ikur kështu investimeve kapitale. Po ashtu ai kërkon të dijë për nivelin e pagave , a disponon Bashkia një sistem vlerësimi performance për punonjësit apo do i lihet dorë e lirë Kryetarit?

Z.Lesha përgjigjet në lidhje me pyetjen e parë duke thënë se procesi ka qënë gjithmonë i njëjtë dhe qeveria ka mbuluar vetëm kufirin minimal të pagave dhe pjesa tjetër nga qeveria vendore. Formula perlllogariëse është e njëjtë kurse përsa i përket pyetjes së dytë, për nëpunësit civil vendimi i qeverisë ka përcaktuar edhe sistemin vlerësues, por paga mund të përcaktohet edhe mbi bazën e funksionit, natyrës së punës, kualifikimit etj.

Z.I.Sokoli shprehet se ai është parimisht dakort për rritjen e pagave por do ishte mirë që kjo të mbulohej nga qeveria qëndrore.

Z.Gjergj Sokoli shprehet entuziast për rritjen e pagave pasi si pasojë e pagës së re të kryetarit, do rriten edhe Honoraret e Këshilltarëve. Por ai kërkon të dijë se kur do fillojnë efektet financiare, prej datës 1 korrik?

Z.Lesha sqaron se efektet financiare me VKM fillojnë nga 1 Shtatori.

Z.Pashuku thotë se administratorët e Njësive administrative sipas mendimit të tij duhet të paguhen njësoj me drejtorët e drejtorisë, sepse nga puna e tyre në terren evidentohen problematikat dhe kërkesat e banorëve të njësive.

Përsëri përgjigjet **Z.Lesha** duke thënë se nuk mund të shkojmë jashtë niveleve minimale dhe maksimale që ka vendosur qeveria.

Z.Bjanku shprehet se në lidhje me këtë pr/vendim është diskutuar edhe në komision. Ai vëren që rritja nuk është e njëjtë për të gjitha kategoritë. Është bërë transparente vetëm paga e Kryetarit dhe e Zv/kryetarëve, pjesa tjetër është lënë krejtësisht në diskrecionin e kryetarit. Ai mendon se duhet të ketë disa kritere që kjo të mos lihet totalisht në dorë të kryetarit.

Fjalën e merr **Znj.Mehmetaj** e cila shprehet se Këshilli Bashkiak miraton pagën minimale dhe maksimale dhe dy nivele të saj, sepse nuk mund të vendosim për secilin punonjës. Pjesa tjetër i takon ekzekutivit.

Përsëri **Z.Bjanku** thotë se duhet të sqarojmë se paga nuk jepet në bazë performance por pozicioni. Për performancë të mirë jepen shpërblime.

Znj.Bajraktari shprehet se tek organigrama e Bashkisë vëen se specialistët janë kategori 3 dhe 4, kurse tek tabela e pagave janë vetëm kategoria 4. Ajo kërkon të dijë a nuk do ketë rritje page për specialistët e kategorisë 3, apo nuk do ketë specialistë kë kësaj kategorie?

Z.Lesha përgjigjet se do rishikohen në përputhje me vendimin e ri.

Znj.Pode përgëzon stafin për përgatitjen e Pr/vendimit pasi mendon se duke shkurtuar numrin e kategorive është më e lehtë edhe kërkesa e llogarisë. Po ashtu ajo ndalet edhe tek

paga e administratorëve të njësive duke thënë se kjo është në porporcion të drejtë me numrin e banorëve që kanë secili në juridiksion.

Kurse **Z.I.Sokoli** shprehet se ky pr/vendim duhet të kishte minimalisht një justifikim financiar të matshëm për rritje pagash.

Z.Shkjau nga ana tjetër thotë se shtesa është minimale por edhe për këtë duhet të jemi të kënaqur dhe të mos ta politizojmë.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **30** vota Pro, **12** Kundër, **1** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 5. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar. Edhe për këtë pikë relaton Z.Denis Lasha.*

Nga ana e komisionit të buxhetit **Znj.Mehmetaj** shprehet se ky pr/vendim është diskutuar edhe në komision me 4 vota pro dhe 1 kundër.Ajo fton kolegët ta miratojnë atë duke patur parasysh kërkesën për punonjës shtesë.

Z.I.Sokoli kërkon të dijë se sa vakanca kemi momentalisht në strukturën e Bashkisë Shkodër dhe së dyti ai thotë se kemi tashmë mjaft fatura gjyqesh për heqje nga puna dhe shkurtime punonjësish. Më përpara ti përgjigjemi këtyre faturave pastaj të kënaqim orekset zgjedhore për vend pune.

Znj.Nika merr fjalën dhe kërkon të dijë në lidhje me punonjësit arsimorë në kopshte dhe çerdhe, pagat për këtë staf kush do ti paguajë?

Për këtë përgjigjet **Znj.Rudina Kruja**, specialiste pranë drejtorisë së arsimit në Bashkinë Shkodër, duke thënë se në bazë të vlerësimit të situatës dhe numrit të shtuar të fëmijëve me aftësi ndryshe është parë e nevojshme të kemi shtim stafi ndihmës.

Z.Anamali shprehet se relacioni i pr/vendimit në fjalë është shumë i vakët dhe mendon se nuk është arsyetuar sa duhet shtimi i punonjësve.

Kurse **Znj.Shkrela** thotë se me marrjen e mandatit Z.Beci hoqi edhe shumë punonjës të djathtë, të cilët sot po fitojnë gjyqet dhe po paguhen nga taksat e qytetarëve. Tani kërkohet shtim numri punonjësish për interesa politike të kryetarit dhe stafit të tij të ngushtë. Po për investime a po mendon kush? - shton ajo. Për më tepër ka shumë projekte të miratuara për këtë vit, por kanë mbetur dhe 2 muaj nga përfundimi i vitit 2024 dhe asnjë nga këto projekte nuk ka filluar. Bashkia Shkodër nuk mund të funksionojë sipas oreksit politik të kryetarit në fushatë elektorale.

Zv/Kryetari Bejleri përgjigjet se nëse shqetësohemi për investimet në Shkodër është mëse e qartë se këtë vit janë në fazë zhvillimi një numër i madh investimesh.

Edhe **Z.Doçi** thotë se në Shkodër nuk po shihet asnjë investim i premtuar.

Z.Luli i tërheq vëmendjen duke thënë se nuk i është dhënë fjala nga ana e tij.

Fjalën e merr **Znj.Kavaja**, e cila mendon se nuk duhet të politizohet mbledhja dhe përse i përket investimeve ato janë të dukshme me fakte konkrete. Ajo shton se duhet përgëzuar shtimi i numrit të punonjësve në mbështetje të fëmijëve me aftësi ndryshe.

Znj.Shkrela ndërhyt përsëri dhe Z.Luli i tërheq vëmendjen për ndërhyrje.

Znj.Mehmetaj i kërkon Kryetarit Luli, që të marr masa që mbledhjet e Këshillit bashkiak të mos shërbejnë si foltore politike.

Replikon **Znj.Shkrela** duke thënë se në momentin që Bashkia Shkodër ka bërë organikën e re duhet të kishte menduar se këto drejtori do kenë nevojë për më shumë punëtorë.

Znj.Duhani shprehet se përderisa Bashkisë i lind nevoja të ketë punonjës ekstra, do të thotë se po punohet në të mirë të qytetit dhe qytetarëve.

Edhe **Znj.Petani** shprehet se nga ana e këshilltarëve ka mungesë etike. Për më tepër ajo përgëzon Kryetarin dhe stafin e Bashkisë për punën që po bëjnë.

Z.Ndou sqaron në lidhje me Rugën e Bardhanjorit që u fol më sipër se është kryer çdo procedurë për finalizimin e projektit. Kurse në lidhje me pr/vendimin në fjalë për rritjen e numrit të punonjësve nuk mendon se numri i kërkuar është i nevojshëm duke parë që ndërmarrja e Shërbimeve publike dhe ajo e Mirëmbajtjes së objekteve publike ka aq shumë punë dhe mbulon një territor kaq të gjërë.

Z.Sokoli shprehet plotësisht dakort me **Znj.Kavaja** duke thënë se çdo mbledhje është kthyer në debat politik.

Znj.Bajraktari merr fjalën përsëri dhe thotë që kur këto drejtori u krijuan kishin mjaftueshëm punëtorë kurse sot shohim në relacionin e paraqitur që janë realizuar vetëm 11% e punëve të planifikuara. Projektet për shkollat sidomos as nuk kanë filluar edhe pse kanë qënë 3 muaj pushime verore. Ajo Kërkon të dijë, pse nuk janë planifikuar që në fillim?

Përgjigjet **Z.Salihi**, drejtor i ndërmarrjes së shërbimeve publike duke thënë se ndërmarrja që ai drejton nuk ka vetëm punonjës administrate por edhe punonjës që merren me të gjitha punët e qytetit. Stafi i kësaj ndërmarrjeje është i përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme që janë të gjithë në terren. Thjesht në fillim nuk i kemi ditur saktësisht nevojat për punonjës, por duke parë në terren vijmë sot me kërkesën për shtim të numrit të punonjësve. Po ashtu edhe **Z.Kullaj**, drejtor i drejtorisë së Mirëmbajtjes së objekteve publike sqaron nevojën për shtim punonjësish.

Z.I.Sokoli thotë se u fol shumë për investime të kryera në Shkodër ndërkohë që në monitorimin e buxhetit thuhet se janë relizuar vetëm 13% e projekteve të parashikuara vjetore.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort, kurse Z.Osmanagaj nga kualicioni BF dhe Z.Sokoli nga PD janë kundër Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 30 vota Pro, 12 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e radhës: Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.*

Relaton në mënyrë sintetike për këtë pr/akt Z.Bejleri dhe në mënyrë analitike sqaron Z.Mema.

Z.Pode merr fjalën përsëri dhe shprehet se këto investime janë të pakta duke patur parasysh nevojat e Njësisë administrative. Nevoja për ndërhyrje në kanalet vaditëse ka qenë edhe kryefjala e dëgjësave publike.

Po ashtu edhe **Z.Pashuku** shprehet mbi nevojën për ndërhyrje në kanalet vaditëse por shton se kjo është vetëm neglizhencë e Ministrisë së Bujqësisë pasi projektet nuk kanë munguar **asnjëherë nga ana e Bashkisë.**

Z.Bejleri sqaron se fondet i sjell Ministria prandaj ne sot kërkojmë vetëm miratimin e 1.2 Milion lekëve të reja për supervizim dhe kolaudim të kësaj vepre.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Z.Ndou** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort, edhe **Z.Osmanagaj** nga kualicioni BF dhe **Z.Sokoli** nga PD janë Pro Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **41** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 7: Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.*

Znj.Pode sugjeron që pr/vendimi në fjalë nuk ka nevojë për relatin por **Z.Luli** sqaron se duhet ndjekur procedura.

Relaton në mënyrë të detajuar **Z.Mema**, sipas materialit të përgatitur. Për pjesën e banesave sociale relaton **Znj.Arlinda Kruja**, drejtoreshë drejtorie e Shërbimit Social.

Z.Bjanku shprehet në lidhje me pjesën e tretë të pr/vendimit, për problematikën e qenëve dhe shton se nga një relacion i OJF, 'Animals need me'del se ka patur një keqmenaxhim të fondeve lidhur me problemin në fjalë (citon relacionin)

Zv/kryetari Z.Beka shprehet se nuk bëhet fjalë aspak për keqmenaxhim nëse krahasojmë situatën që kemi gjetur kur kemi marrë mandatin. Me strategjinë e re të Bashkisë Shkodër së pari kemi staf të specializuar. Situata sot është shumë më e mirë se ajo e një viti më parë. Po punojmë fort për të arritur një zgjidhje përfundimtare.

Relaton në mënyrë analitike lidhur me këtë çështje **Z.Malaj**, drejtor i drejtorisë së Bujqësisë.

Z.Doçi kërkon të dijë se sa është kostoja e një qeni?

Përgjigjet **Z.Malaj** duke thënë se kostoja e një qeni është 3 mijë të vjetra.

Z.Anamali kërkon të dijë se kur është miratuar buxheti i strehëzave pse nuk është parashikuar edhe pjesa e kolaudimit, mbikqyerjes dhe zbatimi? Kurse përse i përket pjesës së parë të pr/vendim për parkingjet në zonën e Shirokës, pyet pse kemi zvoglim zërash buxhetor për këtë?

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se duke parë situatën në terren është parë e nevojshme rivlerësim dhe rishikim i projektit. Është parë e arsyeshme që ky fond të mos mbahet i bllokuar por të lihet i lirë për përdorime të tjera brenda të njëjtit program siç janë strehëza e

qenëvë dhe rikualifikimi i strehëzës së Romëve. Kurse për spjesën e dytë të pyetjes sqaron se nuk bëhet fjalë për shtim fondi në zërin për kolaudim dhe mbikqyrje por për shtim fondi në krejt projektin, për qendrën veterinare dhe shtim kapaciteti.

Z.I.Sokoli kërkon të dijë se ku do merren këto fonde shtesë pasi shërbime falas nuk ka prandaj nëse kemi një donator atëherë le të bëhet publik.

Përgjigjet përsëri **Z.Malaj** se për pajisjen me mikroçipa kemi një donator dhe kontratë të firmosur me të që mund t'ua vëmë në dispozicion.

Znj.Bajraktari mendo se nuk është aspak e llogjikshme të shpërdorohen kaq shumë para për strehëzat e qenëve kur në një kohë ndihma ekonomike është në minimum.

Z.Doçi gjithashtu pyet nëse ju duket e arsyeshme një shpenzim kaq i madh për qentë?

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se kostot për ushqim , shërbim veterinarie nuk mund të reduktohen.

Znj.Shkrela shprehet përsëri se kur themi kemi miratuar krijimin e kësaj strehëze është thënë se do zgjidhej problematika e qenëve kurse sot kërkohet shtim fondi dhe zgjidhje nuk ka akoma. Ajo shton se po flasim për klinikë veterinare në një kohë që këto fonde mund të shkonin për qendra shëndetësore duke patur parasysh edhe kërkesat e dala në dëgjuesat publike në Njësitë administrative.

Përgjigjet përsëri **Z.Malaj** duke thënë se zgjidhje të plotë të qenëve endacakë nuk ka por po punohet fort me sterilizimin me mosbraktisjen e tyre dhe largimin e qenëve të sëmurë dhe të tërbuar nga rruga. Ai shton se mendon se jemi në rrugë të mbarë por gjithmonë ka nevojë për mbështetje.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort, kurse Z.Osmanagaj nga kualicioni BF dhe Z.Sokoli nga PD janë kundër Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **29** vota Pro, **10** Kundër ,**1** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 8. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e rishpërndarjes së fondit brenda të njëjtit program për vitin 2024"* (Blerje pushke CO2 për klinikën në strehëz).

Relaton përsëri shkurtimisht **Z.Mema** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **29** vota Pro, **9** Kundër, **1** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën tjetër: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e udhëzuesit të aplikimit për zbatimin e skemës së granteve"*.

Përsëri relaton shkurtimisht **Z.Mema** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime nuk ka. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 10: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Znj. Merita Sheqeri, Z. Fatbardh Begiri, Znj. Semiha Çelepija, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri"*.

Pikë kjo që nuk ka nevojë për relacion. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën numër tjetër: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025"*.

As kjo pikë nuk ka nevojë të relatohet. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Për sa i takon pikës 12. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024"*. Z. Luli rikujton se mbi këtë pr/vendim është zhvilluar edhe një dëgjese publike.

Z.I.Sokoli merr fjalën përsëri dhe shprehet se për përgatitjen e këtij plani është marr parasysh numri i popullatës në 2011, prandaj mendoj se në momentin e daljes së censusit do kërkohej ndryshime të tjera.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort, kurse Z.Osmanagaj nga kualicioni BF dhe Z.Sokoli nga PD janë kundër Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 29 vota Pro, 11 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën shtesë të rendit të ditës: Pr/vendim *"Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr.6 (ish-Konvikti i Shkollës Pyjore).*

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 38 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës dhe fjalën e merr Z.Shkjau i cili ngre një shqetësim si banor dhe pronar i zonës që përfshihet nga projekti i hyrjes së qytetit dhe thotë se po abuzohet me projektin dhe me pronarët aty. Ai kërkon mirëkuptim dhe mbështetje për pronarët që të mos abuzohet me pronën dhe mundin e tyre.

Z.I.Sokoli kërkon të dijë nëse ka leje ndërtimi projekti në fjalë. Pyetja tjetër ka të bëjë me planin e mobilitetit. Eshtë sjellë një projekt për parkingjet ndërkohë që s'kemi akoma një plan mobiliteti. Gjithashtu ai pyet në lidhje me iniciativën për ndërtimin e kullës dhe kërkon të dijë pozicionin zyrtar të Bashkisë në lidhje me këtë pasi nuk është shprehur akoma.

Znj.Bajraktari thotë se i janë paraqitur disa të dhëna: Raporti i shpenzimeve dhe i të ardhurave, ku vëren që ka mospërputhje të të dhënave mes raportit të paraqitur dhe pasqyrës përmbledhëse.

Z.Bejleri përgjigjet se në lidhje me detajet teknike (pasi një pjesë e drejtorëve janë larguar nga salla) do t'ju përgjigjem zyrtarisht.

Vijon **Znj.Bajraktari** duke thënë se tek të ardhurat ka një zë që bën shumë përshtypje mbi gjërat e policisë bashkiake. Nga periudha gusht 2023 në gusht 2024 rritja është 20 fish më e madhe. Ajo falenderon Punonjësit e policisë bashkiake për punën e përditshme por shprehet se mendon se ato janë nën presion për përmbushjen e një plani absurd që i vjen me urdhër nga lart, dhe ndihet të detyruar të vendosin gjëra ku të munden. Ajo dëshiron të theksojë faktin se po krijohen shumë pakënaqësi dhe kjo ka sjell edhe largimin e qytetarëve.

*Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Z.Luli** e deklaron mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 30.9.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 11 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



KRYETAR

Oltion LULI



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

